

INDEKSI I ÇMIMEVE TË PRODHIMIT

Tremujori I, 2026

Në tremujorin e parë të vitit 2026, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP) arriti 129,7, kundrejt vitit 2021(2021 = 100). Krahasuar me tremujorin e parë 2025, IÇP shënoi rritje me 0,02%.


Rritja më e lartë vjetore u regjistrua në seksionin "Industri përpunuese" me 0,4%, ndërsa seksioni "Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve" shënoi rritje me 0,3%. Nga ana tjetër, seksioni "Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri i kondicionuar" shënoi ulje me 0,9%.

Për tregun vendas, IÇP u rrit me 0,3% krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2025, ndërsa për eksportet shënoi ulje me 0,5%.

Krahasuar me tremujorin e katërt 2025, IÇP shënoi rritje me 0,1%. Rritja më e lartë vjetore u shënuar në seksionet "Industri përpunuese" me 0,4 %, ndjekur nga seksionet "Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve" me 0,3 %. Brenda seksionit "Industri përpunuese", rritja më e madhe e çmimeve vërehet në aktivitetet "Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi", "Prodhimi i pijeve", "Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara" dhe "Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës" me 1,2 % secila.

Ndërsa ulja më e madhe e çmimeve vërehet në aktivitetin "Prodhimi i paisjeve elektrike" me 0,9 % dhe aktiviteti "Metalurgjia" me 0,6%. Nga ana tjetër, seksioni "Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri i kondicionuar" shënoi ulje prej 0,9 %.

FIG. 1 INDEKSI I ÇMIMEVE TË PRODHIMIT



Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara vjetore sipas aktiviteteve ekonomike janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Indeksi i Çmimeve të Prodhimit](#), si dhe në seksionin e tabelave në website në temën: [Indeksi i Çmimeve të Prodhimit](#)

Metodologjia

Ndryshime metodologjike

INSTAT llogarit dhe publikon:

- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit Gjithsej
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit të produkteve për eksport

Fusha e mbulimit:

- Seksioni B - Industri nxjerrëse
- Seksioni C – Industri përpunuese
- Seksioni D - Furnizimi me energji elektrike, gaz e avull dhe me ajër të kondicionuar
- Seksioni E - Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas degëve të ekonomisë në nivel 2-shifror. Rinovimi i kampionit të ndërmarrjeve dhe shportës së produkteve realizohet çdo vit duke përdorur rezultatet e Anketës Strukturore pranë Ndërmarrjeve Ekonomike jo Bujqësore. Përcaktimi i peshave të produkteve me destinacion tregun vendas mbështetet në rezultatet e po kësaj ankete, ndërsa peshat e produkteve me destinacion eksportin mbështeten në të dhënat statistikore të Tregtisë së Jashtme.

Duke filluar nga tremujori i parë 2024 e në vazhdim Indeksi i Çmimeve të Prodhimit ka si periudhë referuese vitin 2021 = 100. Metoda e llogaritjes së indeksit është metoda zinxhir (Laspeyres - chain index) sipas së cilës, çmimi i produktit në periudhën korente (y) krahasohet me çmimin e muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm (y - 1);

$$I_{korrent}^{y,m} = \frac{100}{12 \sum^{Dec} I_{Y-1,Dec}^{Y,M}} + \prod_{Y=viti\ bazë}^{y-1} I_{Y-1,Dec}^{Y,M} * I_{y-1,Dec}^{y,m}$$

- Pjesa e parë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve të muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm krahasuar me mesataren e çmimeve në vitin bazë.

- Pjesa e dytë e formulës tregon lëvizjen zinxhir të indeksit të çmimeve nga muaji Dhjetor të vitit të mëparshëm deri në periudhën y-1.
- Pjesa e tretë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve nga muaji Dhjetor y-1 në muajin m të vitit y.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori. Ndryshimi tremujor krahason nivelet e çmimit të dy tremujorëve të fundit.